



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
ADMINISTRATORI

Nr. 2648/Prot.

Tiranë, më 03/10/2024

**NJOFTIM
RISHPALLJE PËR APLIKIM PËR EKSPERT TË JASHTËM INXHINIER
NDËRTIMI**

(angazhim me kontratë shërbimi)

Universiteti i Sporteve të Tiranës, në zbatim të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në kuadër të zbatimit të kontratës për procedurën me objekt: “Rikonstruksion e Fushës Futbollit, Pistës Atletikës dhe rrethimi në Universitetin e Sporteve të Tiranës” të Autoritetit Kontraktor, Universiteti i Sporteve të Tiranës, për të qenë pjesë e Grupeve të Punës, kërkohet 1 (një) Inxhinjer i fushës së Inxhinjerisë së Ndërtimit, (të angazhuar me kontratë shërbimi).

Eksperti duhet të plotësojë këto kriterë:

1. Të ketë përfunduar studimet universitare ose pasuniversitare sipas fushës së kërkuar, (Inxhinier Ndërtimi).
2. Të ketë eksperiencë pune mbi 10 (dhjetë) vite.
3. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje.

Kandidatët që aplikojnë, duhet të dorëzojnë brenda datës 09.10.2024, në zyrën e Protokollit të Universitetit të Sporteve të Tiranës, këto dokumenta:

- Kërkesë me shkrim për aplikim;
- Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard (europass);
- Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
- Kopje e noterizuar e diplomës/diplomave dhe njehsimin e tyre në MAS (për diplomat e marra jashtë vendit);
- Liçencë e certifikuar në fushën e Inxhinierisë së ndërtimit;
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore, vetëdeklarim sipas formës së kërkuar nga ligji;
- Vetëdeklarim mbi parandalimin e konfliktit të interesit.

Mënyra e vlerësimit: Përzgjedhja e kandidatit fitues do të bëhet nëpërmjet konkurrimit me dosje.

ADMINISTRATORI

Haxhirete Sulaj

